



Udhëzime për plotësimin e formularit të ndihmës financiare 2018-2019

Informacion i përgjithshëm

Pranimi në AUBG bazohet në bazë të arritjeve akademike të studentëve.

AUBG u ofron studentëve shumë bursa të mundësuar nga dhurues privatë dhe të korporatave. Bursat mund të jenë të plota ose të pjesshme, dhe shpërndarja e tyre bëhet sipas kushteve specifike nga dhuruesit. Disa donatorë dëshirojnë të mbështesin ekselencën akademike, ndërkohë të tjerë dëshirojnë të mbështesin studentët në nevojë financiare.

Universiteti jep ndihma financiare të bazuara në arritjet akademike ose nevojën financiare të studentit, por gjithashtu të dyja së bashku. Ndihma financiare vendoset nëpërmjet një shqyrtimi të Aplikimit për Ndihmë Financiare në AUBG dhe dokumentave plotësuese që dorezohen si pjesë e paketës e aplikimit.

Ndihma financiare mbulon një pjesë të tarifës së shkollimit dhe nuk ka nevojë të shlyhet nga studenti. Ndhmat financiare jepen në vazhdimësi për një maksimum prej tetë semestrash rregjistrimi dhe kushtëzohen nga një performancë e mire akademike.

Universiteti Amerikan në Bullgari i bindet Ligjit për Mbrojtje të të Dhënave Personale. Ky informacion personal i studentit mbahet rreptesisht konfidencial dhe përdoret vetëm nga Këshilli i Ndihmës Financiare për të vendosur bursën që do t'i akordohet studentit të mundshëm. Dokumentat e paraqitura në mbështetje të Aplikimit për Ndihmë Financiare, mbeten në pronësi të përhershme të AUBG dhe nuk do të rikthehen.

Universiteti Amerikan në Bullgari rezervon të drejtën e shqyritimit të vërtetësisë dhe saktësisë së gjithë informacionit të dhënë në formularët e aplikimit. Plotësimi me të dhëna të rreme ose jo të sakta në Formularin e Aplikimit për Ndihmë Financiare çon në anulimin e çdo lloji burse të dhënë paraprakisht dhe mund të përfundojë me refuzim nga AUBG, pa të drejtën për të riaplikuar. Informacioni në Formularët e Aplikimit për Ndihmë Financiare së bashku me dokumentat plotësuese duhet të jepet në mënyrë vullnetare.

Universiteti Amerikan në Bullgari është i përkushtuar ndaj një rregulloreje jo diskriminuese, me mundësi të barabarta, në të gjitha pikesynimet e tij dhe konfirmon angazhimin e tij ndaj diversitetit tek të gjithë punonjësit ashtu si edhe tek studentët.

Udhëzime:

Aplikimi për Ndihmë Financiare (ANF) është pjesë e pandashme e paketës suaj të aplikimit për nëse ju dëshironi për bursë me bazë nevojshmërie për asistencë financiare. Universiteti ruan disa nga ndhmat e tij financiare për të ndihmuar student që demonstrojnë nivele të larta për

ndihmë dhe disa nga bursat e donatorëve akordohen në mënyrë që të jenë dhurata mbështetëse për këta student në nevojë. Asnje bursë mbi bazë merite nuk do të akordohet pa një formular ANF dhe pa të gjithë dokumentat plotësuese. Nëse ju nuk dorëzoni një formular ANF, ju nuk do të merreni parasysh për asnjë lloj burse mbi bazë nevojë. Nëse ju zgjidhni të mos dorëzoni një formular ANF kur ju aplikoni, ju nuk mund të riaplikoni për të rivendosur vlefshmëri për bursa mbi bazë nevojë për dy semestrat e pranimit. Universiteti nuk mund të mbështesi të gjithë studentët me nevoja dhe nuk mund të sigurojë bursa që përmbushin plotësisht të gjitha nevojat financiare të cdo student. Duke qënë se bursat që jepen bazohen në vlerësimin e dokumentavekonfidenciale të siguruar nga të gjithë aplikuesit dhe familjet e tyre, Universiteti nuk mund të sigurojë asnje nga aplikantët me një shpjegim të detajuar për vendimin e ndarjes së ndihmave financiare.

Formulari nuk do të quhet I përfunduar nëse nuk shoqërohet nga dokumentat plotësues të rreshtuar në listën që kërkohet. Nëse nuk u është kërkuar që të përfshihet ndonjë document ose dokumenti nuk është I vlefshëm për ju, ju këshillojmë të shikoni listën e kërkesave. Duke firmosur aplikimin, ju kërkon që të merret në shqyrtim kërkesa juaj mbi bazën e dokumentave të përfshira. Ju nuk mund të përfshini dokumenta shtesë më vonë.

Në pamundësi të plotësimin të ndonjërit nga paragrafët e aplikimit ose të dërgoni ndonjë nga dokumentat e kërkuar, ju lutem përfshini një shpjegim tuajin në rreshtin 53. Dërgimi I këtij formulary me dokumentacion të mangët ose të paplotë do ta bëjë automatikisht aplikimin të pavlefshëm. Ju lutemi që të kontaktoni Zyrën e Ndhmës Financiare në AUBG për cdo pyetje që keni në adresën financialaidoffice@aubg.edu

Udhëzimet sipas cdo rreshti:

Rreshti 1 Shkruani emrin e aplikantit për në AUBG, duke filluar me mbiemrin me shkronja KAPITALE, ndjekur nga emri, dhe më pas emri i mesit (nëse ka).

Rreshti 2 Shënoni me kryq në kutinë pranë Mashkull nëse aplikanti është mashkull, ose shënoni me kryq në kutinë pranë Femër nëse aplikanti është femër.

Rreshti 3 Shkruani datën e lindjes së aplikantit, duke listuar së pari MUAJIN, më pas DATËN, më pas VITIN.

Rreshti 4 Tregoni duke shënuar me kryq kutinë nëse aplikanti synon të fillojë studimet në AUBG në Vjeshtë 2018 apo Pranverë 2019

Rreshti 5 Shkruani shtetin e shtetësisë së aplikuesit.

Rreshti 6 Shkruani emrin e shtetit ku aplikanti po qëndron momentalisht.

Rreshti 7 Shkruani emrin e qytetës, qytetit, ose fshatit ku aplikanti jeton.

Rreshti 8 Shenoni me kryq në kutinë që përshkruan gjendjen civile aktuale të prindërve biologjike të aplikantit. (Ju lutem shënoni me kryq vetëm në një kuti.)

Rreshti 9 Ju lutem shkruani numrin e personave në familjen tuaj. Përfshini prindërit dhe motra ose vëllezërit, dhe njerkun ose njerken (nëse ka). Mos përfshini familjare që nuk jetojnë më.

Rreshti 10 Në rreshtat 10a deri në 10f, listoni personat aktualë në familjen tuaj. Listoni personin me të ardhurat më të larta në rreshtin 10a, personin e dytë me të ardhurat më të larta në rreshtin 10b, dhe personin e tretë me të ardhurat më të larta në rreshtin 10c. Në kolonën “Lidhja me aplikantin”, shkruani lidhjen familjare midis aplikantit dhe personit (i ati, e ëma, motra etj) . Në kolonën “Moshë” listoni moshën aktuale të personit. Nëse ka pjesëtarë të tjerë të familjes, listojini ata në fletën shtesë.

Rreshti 11 Në rreshtat 11a deri tek 11c, jepni detaje rreth pjesëtarëve të familjes që janë studentë me kohë të plotë në shkollë ose universitet. Tek “Kostoja vjetore e Shkollimit” shkruani koston totale të shkollimit plus tarifën e detyrueshme vjetore në atë shkollë ose universitet. Tek “Kontributi familjar” shkruani pjesën e kësaj shume që paguhet kolektivisht nga pjesëtarët e familjes së studentit. Tek “Inst. Kredi/punë” shkruani Shumën e mbështetjes financiare që merr studentin nga shkolla ose universiteti i tij/saj. Kjo shumë duhet të jetë diferenca ndërmjet “Kostot vjetore të Shkollimit” dhe “Kontributit familjar”. Shkruani N/A në rreshtin 11a nëse nuk ka asnjë anëtar të familjes në shkollë, ose si student me kohë të plotë në universitet.

Rreshti 12 Shënoni me kryq në kutinë që përshkruan saktësisht residencën primare të vendbanimit aktual të familjes. Shënoni me kryq “Zotëroj” nëse familja e zotëron residencën. Shënoni me kryq “Me qera” nëse familja e ka marrë me qera rezidencën primare të vendbanimit. Shënoni me kryq tek “Jetoj me të tjerët” nëse familja jeton në një residencë të zotëruar nga dikush tjetër jashtë familjes dhe nuk paguan qera.

Rreshti 13 Për personin listuar në rreshtin 10a (me të ardhurat më të larta në familjen e aplikantit), listoni emrin e personit (Mbiemrin, Emrin, Emrin e Mesit). Në rreshtin 13a shkruani punësimin e këtij personi. Në rreshtat 13b deri 13g, jepni adresën e plotë të punëdhënësit të këtij personi. Në rreshtin 13h, jepni numrin e telefonit të punëdhënësit të personit në fjalë.

Rreshti 14 Për personin listuar në rreshtin 10b (me të ardhurat e dyta me të larta në familjen e aplikantit), listoni emrin e personit (Mbiemrin, Emrin, Emrin e Mesit). Në rreshtin 14a shkruani punësimin e këtij personi. Në rreshtat 14b deri 14g, shkruani adresën e plotë të punëdhënësit të këtij personi. Në rreshtin 14h, jepni numrin e telefonit të punëdhënësit të personit në fjalë.

Rreshti 15 Për personin e listuar në rreshtin 10c (me të ardhurat e treta me të larta në familjen e aplikantit), listoni emrin e personit (Mbiemrin, Emrin, Emrin e Mesit). Në rreshtin 15a shkruani punësimin e këtij personi. Në rreshtat 15b deri 15g, shkruani adresën e plotë të punëdhënësit të këtij personi. Në rreshtin 15h, jepni numrin e telefonit të punëdhënësit të personit në fjalë.

Rreshti 16 Ju lutem jepni çfarëdo informacioni shtesë në lidhje me punësimin.

Rreshtat 17-22 Në këto rreshta, listoni të ardhurat bruto (të ardhurat totale përpara taksave) të babait të aplikantit (rreshti 17), mamase (rreshti 18), të aplikantit vetë (rreshti 19), të bashkeshortit/es së aplikantit (rreshti 20), të çdo personi tjetër me të ardhura të listuar në

rreshtat 10a, 10b, ose 10c (rreshti 21). Ne rreshtin 22, shtoni shifrat konkrete ne cdo kolone per te ardhurat bruto ne total, taksat totale mbi te ardhurat te paguara, dhe te ardhurat totale neto per familjen. Ne cdo rast, listoni te ardhurat vjetore per vitin me te afer te plotesuar ne monedhen kombetare vendase.

Rreshtat 23-28 Ne keto rreshta, listoni te ardhurat totale nga shitjet, shpenzimet totale, fitimin (humbjen) e bizneseve te drejtuara/menaxhuara nga babai I aplikantit (rreshti 23), mamaja (rreshti 24), aplikanti vete (rreshti 25), bashkeshorti I aplikantit (rreshti 26), cdo person tjeter me te ardhura te listuara ne rreshtat 10a, 10b, ose 10c (rreshti 27). Ne cdo rast, raportoni shifrat vjetore per vitin me te aferm te plotesuar me taksat. Ne rreshtin 28, shtoni shifrat ne cdo kolone per shitjet totale, shpenzimet totale, fitimin (humbjen) per familjen. Ne kolonen (iv) shkruani numrin e njerezve te punesuar ne keto biznese.

Rreshti 29 Na siguroni cdo informacion shtese per bizneset ne rreshtat 23-28.

Rreshtat 30-35 Ne keto rreshta, listoni pensionin vjetor, kompensimin total per papunesi, ushqime te marra me ndihme, perfitimet nga sigurimet shoqerore dhe qera te marra nga babai I aplikantit (rreshti 30), mamaja (rreshti 31), aplikanti vete (rreshti 32), bashkeshorti I aplikantit (rreshti 33), cdo person tjeter me te ardhura te listuara ne rreshtat 10a, 10b, ose 10c (rreshti 34). Ne rreshtin 35, shtoni shifrat perkatese ne cdo kolone per pensionin total, kompensimin total per papunesi, ushqime te marra me ndihme, dhe perfitimet nga sigurimet shoqerore.

Rreshti 36 Ne kete rresht, shtoni numrat nga kolona e trete e rreshtit 22 (te ardhurat neto), nga kolona e trete e rreshtit 28 (fitimi), dhe gjithë kolonat e rreshtit 35 per te nxjerre te ardhurat totale te familjes dhe rezultatin shkruajeni ne rreshtin 36.

Rreshtat 37-42 Ne keto rreshta, listoni balancat e shumave ne llogarite bankare te babait te aplikantit (rreshti 37), mamase (rreshti 38), te aplikantit vete (rreshti 39), te bashkeshortit/es e aplikantit (rreshti 40), te cdo personi tjeter me te ardhura te listuar ne rreshtat 10a, 10b, ose 10c (rreshti 41). Ne rreshtin 42, shtoni shifrat ne rreshtat 37 deri 41 per te nxjerre kursimet totale te familjes.

Rreshti 43 Nese ndonje anetar I familjes se aplikantit zoteron nje shtepi, apartament ose toke – jepni detajet e meposhtme: (i) emri I pronarit; (ii) pershkrim I shtepise, apartamentit, ose tokes; (iii) adresa e shtepise, apartamentit, ose tokes. Listoni cdo objekt pronarie mevetesisht ne rreshtat 43a, 43b, dhe 43c. Bashkangjitni faqe shtese nese duhet.

Rreshti 44 Jepni informacion mbi te gjitha automjetet e zoteruara nga anetaret e familjes se aplikantit. Jepni (i) emrin e prodhuesit (ose markes); (ii) emrin e modelit; (iii) vitin e prodhimit; dhe (iv) numrin e licenses.

Rreshti 45 Jepni informacion ne lidhje me udhëtimet nderkombetare te aplikantit. Per cdo udhëtim, listoni (i) shtetin e vizituar; (ii) qellimin e udhëtimit (biznes, turizem etj.); (iii) daten e udhëtimit (muaji/viti).

Rreshti 46 Jepni nje perafersi te kontributit financiar qe familja e aplikantit planifikon te beje ne vitin e ardhshem akademik. Shpreheni kete shume ne USD.

Rreshti 47 Jepni nje perafersi te kontributit te bursave (nese ka) qe do i jepen aplikantit nga burime te tjera pervec AUBG. Shpreheni kete shume ne USD.

Rreshti 48 Jepni nje perafersi te kontributit financiar nga te afermit dhe shoqeria jashte familjes se aplikantit per vitin e ardhshem akademik. Shpreheni kete shume ne USD.

Rreshti 49 Jepni nje perafersi te kontributit financiar nga sponsore private per vitin e ardhshem akademik. Shpreheni kete shume ne USD.

Rreshti 50 Jepni nje perafersi te kontributit financiar per vitin e ardhshem akademik qe vjen nga te ardhurat gjate pushimeve te aplikantit. Shpreheni kete shume ne USD.

Rreshti 51 Jepni nje perafersi te kontributit financiar nga cdo lloj burimi tjetër qe nuk eshte i listuar ne rreshtat 46-50 per vitin e ardhshem akademik. Shpreheni kete shume ne USD.

Rreshti 52 Shtoni shumat e listuara ne rreshtat 46-51 dhe shkruani totalin.

Rreshti 53 Perdoreni hapsiren me poshte per te shtuar komente dhe shpjegime ne lidhje me kontributet e permendura me siper. Gjithashtu permendni ndonje rrethane te vecante qe mendoni se duhet ta konsiderojme kur te vendosim shumen e asistences qe ju mund te keni nevojte. Perfshini informacion dhe dokumentacion ne lidhje me kredi aktuale te papaguara/vonuara, objekte te lena peng, dhe qera te paguar. Bashkangjitni fleta shtese nese e shihni te nevojshme.

Rreshti 54 Plotsoni listen (checklist) te dokumentave te kerkuara per te mbeshtetur aplikimin. Dokumentat qe mbeshtesin (ANF) duhet te jene origjinalet ose kopje te noterizuara. Te gjitha certifikatat dhe dokumentat e tjera duhet te jene Brenda 12 muajve te fundit dhe te perkthyer ne anglisht (nga nje perkthyes te licensuar), me perjashtim te rastit kur jane ne bullgarisht. Shenoni me kryq ne kutine N/A per cdo kerkese qe nuk ju perket (psh, nese asnje kompensim papunesie nuk merret nga babai - shenoni me kryq kutine N/A poshte kolones per babain ne rreshtin 54e).

Dokumentat e kerkuara jane:

- a. Te ardhurat bruto dhe neto me shperndarje mujore deri ne daten e aplikimit. Ky dokument kerkohet per cdo anetar te familjes ne marredhenie pune, duke perfshire dhe aplikantin.
- b. Kopje te Deklaratave Vjetore te Taksave per te ardhurat e taksuara te vitit te fundit (duke perfshire aktivitetet e biznesit privat, posedimin e aksioneve ne kompani private/publike, qera e marre nga dhenia me qera e godinave te zoteruara, si edhe cdo lloj te ardhure tjetër shtese) per cdo anetar te familjes ne marredhenie pune, duke perfshire dhe aplikantin.
- c. Çertifikate qe provon mungesen e aktiviteteve tregtare e leshuar nga Autoritetet Taksuese perkatese. Bashkangjitur me te, cdo prind duhet te paraqese nje deklarate noteriale ku ai/ajo deklarone ne menyre transparente qe ai/ajo nuk praktikon ndonje aktivitet tregtar ne ndonje forme a ndonje tjetër dhe qe ai/ajo nuk ka te ardhura ose prona te patundshme me perjashtim te atyre te deklaruara. Deklarata duhet te

permbaje shprehimisht informacion qe prinderit jane ne dijeni te ndjekjes penale qe do te ishin subjekt te parashtruar nga Ligji Penal ne rast se thyejne kriteret e deklarates.

- d. Certifikata per kursimet familjare te leshuara nga banka.
- e. Certifikata nga Zyra e Punes per anetaret e papune duke indikuar shumen e kompensimit per papunesi.
- f. Certifikata per pensionet duke perfshire dhe shumen e marre.
- g. Kopje te vendimeve te gjykates ne rastin e prinderve te divorcuar. Gjithashtu, prindi duhet te paraqese nje certificate rreth statusit te tij/saj aktual martesor leshuar nga autoritetet perkatese. Informacioni i kompletuar financiar duhet te jepet per te dy prinderit edhe nese jane te divorcuar.
- h. Certifikata per ndihma ushqimore, nese jane te aplikueshme.
- i. Kopje te certificates/ave te vdekjes ne rast te prindit/erve te vdekur. Bashkangjitur me te, prindi duhet te paraqese statusin martesor dhe certificate te te afermit te leshuar nga autoritetet perkatese.
- j. Certifikata per paaftesi shendetesore ose probleme mjeksore, nese ka.
- k. Dokumenta te rregjistrimit te te gjitha automjeteve te zoteruara nga anetaret e familjes ose bizneseve private te zoteruara nga anetaret e familjes.
- l. Certifikata te pronesise per te gjitha pronat (shtepi, apartament, ose toke) te zoteruara nga anetaret e familjes.

Rreshti 55 Aplikanti dhe prindi duhet te firmosin deklaraten. Duke firmosur, te dyja palet deshmojne qe:

- (i) Udhezimet jane lexuar dhe kuptuar.
- (ii) Informacioni i dhene ne kete aplikim eshte i plote dhe i sakte.
- (iii) Aplikimet per asistence financiare qe jane te paplota ose me dokumenta qe mungojne jane te pavlefshme.
- (iv) Sapo aplikimi të dorezohet , nuk ka me mundesi te dorezohen dokumenta shtese ose aplikime te reja per asistence financiare per vitin aktual.